



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 21. 06. 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Duda Balje, Justina Shiroka - Pula, Ismet Beqiri dhe Albana Gashi.

Pjesëmarrës të tjerë: Xheladin Hoxha, shef i komisioneve në Departamenti Ligjor, Terina Dampier - OSBE, Lejla Selimi – OSBE, Srđan Mibjević - EEUSR, Uke Gashi-ZPRK, Isa Hasani - IAP dhe Burim Tahiri, praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzan Novoberdaliu – kryetare.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 majit dhe i procesverbalit të mbledhjes së 10 qershorit 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për personat e zhdukur dhe caktimi i raportuesve;
4. Miratimi i konkursit për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit;
5. Shqyrtimi i disa peticioneve;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 majit dhe i procesverbalit të mbledhjes së 10 të qershorit 2011

Kymete Bajraktari - Lidhur me procesverbalin e datës 25 maj pati vërejtje që ka të bëjë me fjalinë ku flitet për Hagën. Tha se duhet të përmirësohet, si vijon; „krimi duhet dënuar në vendin e krimit”.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për personat e zhdukur dhe caktimi i raportuesve

Kryetarja – Tha se Komisioni ynë është funksional për këtë Projektligj që e ka kaluar leximin e parë në Kuvend. Me këtë rast nga ana e deputeteve u dhanë shume vërejtje. Vuri në dukje se anëtarët e Komisionit do ta japin kontributin gjatë shqyrtimit të tij dhe do të caktohen raportuesit, sepse sipas saj ky Projektligj është i ndjeshëm dhe ka rëndësi të veçantë.

Komisioni pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me emërimin e raportuesve njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Komisioni e emëroi z. Kurtan Kajtazi raportues kryesor, kurse anëtar i emëroi Kymete Bajraktarin, Biserka Kosticin, Rita Hajzerajn, Albana Gashin dhe Duda Baljen, që t'i ndihmojnë rreth shqyrtimit të Projektligjit. Raportin bashkë me amendamente ata do t'ia paraqesin Komisionit.

4. Miratimi i konkursit për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryetarja – Tha se ligji dhe rregullorja e përcaktojnë përmbajtjen e konkursit. Në këtë kontekst vuri në dukje se nga Zyra e Personelit të Kuvendit e kemi një draftkonkurs dhe një variant të aplikacionit, që i kanë paraparë kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

Biserka Kostiq – Bëri vërejtje për mungesën e draftkonkursit në gjuhën serbe. Për këtë përkthyesit do t'i japin sqarimet e duhura, sepse drafti ende nuk ka kaluar zyrtarisht.

Rita Hajzeraj – Kërkoi që dokumentet të jenë origjinale e jo të fotokopjuara.

Rita Hajzeraj-Beqaj – Tha se e njëjta rregullore që vlen për zgjedhjen dhe për shkarkimin e Avokatit të Popullit, vlen edhe për zgjedhjen e zëvendësve të tij. Në nenin 11 flitet vetëm për procedurën e zgjedhjes. Aty nuk thuhet se për këtë rast duhet të bëhet një panel tjetër rekrutues. Pra aty flitet për të njëjtin panel që formohet edhe për zgjedhjen

e Avokatit të Popullit. Kjo është në harmoni me nenin 3 dhe me nenin 4. Nëse ne nuk kemi të drejtë, atëherë cili është ky panel rekrutues për të cilin flitet në nenin 11?

Ismet Beqiri - Në Legjislatura e Tretë kemi pasur komision të veçantë për intervistimin e Avokatit të Popullit. Shtoi se kompetencat e Komisionit për Legjislacion dhe ato të Komisionin për të Drejtat e Njeriut janë përzier. Theksoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut gjithsesi duhet të jetë i veçantë, por duhet të sqarohen mirë procedurat ligjore.

Kurtan Kajtazi - Ua përkujtoj se edhe në seminarin për intervistim të mbajtur kohë më parë kemi debatuar lidhur me këtë pikë. Vetë fakti që e kemi mbajtur atë seminar me njohësit më të mirë për të drejtat e njeriut, flet se paneli është përgatitur si duhet të bëhet intervistimi i kandidatëve, prandaj nuk ka mekanizëm tjetër që mund ta bëjë këtë. Nëse kemi paqartësi mund t'i bëjmë kërkesë Komisionit për Legjislacion dhe të na përgjigjet se a jemi ne panel për intervistim.

Justina Shiroka Pula - Puna e panelit është ta shikojë dokumentacionin e kandidatëve. Ata që nuk i plotësojnë kriteret do të eliminohen. Mendoj se nuk do të ketë kandidatë të tillë që nuk i plotësojnë kushtet. Shpresoj se të gjithë ata që konkurrojnë për këtë pozitë janë me begraund moral dhe intelektual. Unë nuk jam për atë që paneli ta bëjë intervistimin e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit.

Xheladin Hoxha, shëf i komisioneve në Departamenti Ligjor – I sqaroi anëtarët e Komisionit se Komisioni sipas rregullores është i autorizuar vetëm për selektimin e dokumentacionit dhe nuk ka të drejtë për intervistimin e kandidatëve.

Pas një debati të gjërë dhe konstruktiv rreth shpalljes së konkursit për zëvendës të Avokatit të Popullit e nxori këtë

Përfundim

I. Komisioni e ngarkoi Zyrën e Personelit të Administratës së Kuvendit të Kosovës që në pajtim me Rregulloren për zgjedhjen dhe për shkarkimin e Avokatit të Popullit, si dhe të zëvendësve të tij, ta publikojë konkursin në mjetet e informimit si vijon: në Koha Ditore, Epoka e Re, Bota Sot, në radio Blu Skaj, si dhe në mediat në Prizren.

II. Komisioni vendosi me gjashtë vota pro dhe tri kundër të kërkojë interpretim ligjor nga Komisioni për Legjislacion lidhur me nenin 11 për zgjedhjen dhe për shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij se a bie kjo çështje në fushëveprimtarinë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut për intervistimin e kandidatëve.

5. Shqyrtimi i disa peticioneve

Kryetarja – I ftoi raportuesit **Rita Hajzeraj dhe Kurtan Kajtazi** që në pika të shkurtra ta njoftojnë Komisionin për përmbajtjen e peticioneve dhe për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Sa i përket petitionit nga A. R., raportuesi sugjeroi që kjo çështje t'i adresohet gjykatës kompetente që merr vendim meritör.

Për petitionin e N. B dhe për petitionin e I. M., që ngrenë shqetësime për moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme, Komisioni konsideron se çështja, që ato e trajtojnë, nuk i përket fushëveprimtarisë së tij. Prandaj kërkon që të gjitha institucionet relevante shtetërore të Kosovës t'i zbatojnë vendimet e plotfuqishme në fushëveprimtarinë e tyre.

Komisioni konsideron se çështja e ngritur në ankesën e N. J., nga komuna e Lipjanit, i përket fushëveprimtarisë së gjykatës, prandaj e udhëzon ankuesin të kërkojë mbrojtje juridike lidhur me të drejtën pronësore nga gjykata përkatëse.

Komisioni u njoftua për disa kërkesa të pazgjidhura dhe u sugjeroi raportuesve që në mbledhjen e radhës ta prezantojnë zgjidhjen për to. Gjithashtu u ngrit shqetësimi rreth moszbatimit të vendimeve dhe të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Po ashtu u tha se Komisioni do t'i marrë të gjitha masat e duhura, brenda fushëveprimtarisë së tij, që këtë çështje ta sensibilizojë në Kuvendin dhe në institucionet e tjera relevante të Kosovës.

6. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati kërkesa.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Suzan Novoberdaliu